

e tyre. Ishte pylltar. Në mbrëmjen e datës 31.06.1998, në shtëpinë e familjes Xhemshiti erdhën disa ushtarë të UÇK-së. Kërkonin që Lutfiu ta dorëzonte pushkën. Ai e bëri këtë dhe ata u larguan. Në datën 2.07.1998, nga ora 2:00 pas mesnatës, pjesëtarë të UÇK-së erdhën sërish. I urdhëruan Lutfiut që të shkonte me ta për shkak të marrjes së tij në pyetje. Familjes i thanë se Lutfiun do ta lëshonin në mëngjes. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë.

Luftiu ka qenë i burgosur në llogoren e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. E kishin rrahur shumë. Në datën 25 apo 26.07.1998, atë e pushkatuan me një grup të burgosurish në **Malet e Berishës/Berishine planine**. Mbetjet e tij mortore janë zhvarrosur nga varreza masive në **Malet e Berishës/Berishine planine** në muajin prill të vitit 2001. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Lutfiut në varrezat e fshatit të tij të lindjes ë 2.02.2004. Për vrasjen e Lutfiut dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

Burimet: deklarata B.X, FDH-11609; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 28.02.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedok%20Ramiz%20Qeriqi%20-%2028.02.2005..pdf>; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 15.11.2004, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Uvodna%20rec%20Tuzilastva%20-%2015.11.2004..pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-66-);) ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 06.04.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj-svedok%20Dragan%20Jasovic-6.04.2005..pdf>; FDP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-27001; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPF, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Shyqeri (Rashit) Zymeri

(16.06.1966, shqiptar nga Godanci i Poshtëm/

Donje Godance, komuna e Shtimes/Štimlje, tre fëmijë)

Ditën e shtunë, më 27.06.1998, gjysmë ore pas mesnate, tetë pjesëtarë të maskuar të UÇK-së kanë hyrë në oborrin e familjes Zymeri. E thirrën me emër babanë e Shyqeriu, Rashitin. Kërkuan që i biri ta dorëzonte pushkën e gjuetisë. Vajza e Rashitit e dorëzoi pushkën e kërkuar. Atëherë, ata kërkuan që Shyqeriu të dilte jashtë shtëpisë. Pasi doli, e kontrolluan dhe, më pas, i kërkuan që tu dorëzonte edhe revolen. Ai u përgjigj që nuk e kishte dhe se kurrë as që e mbante. Por, ata insistuan që ai ta dorëzonte revolen apo të nisej me ta. Kur ai përsëriti se nuk e kishte revolen, atëherë ata e morën në pyetje vëllain e tij të vogël. Në fund, i urdhëruan Shyqeriu që të vishej dhe të nisej me ta. Rashiti u bëri pyetje ku do ta çonin djalin e tij. U përgjigj se “nuk do ta shihte kurrë më.”

Shyqeriu e kanë çuar në kampin e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Atje, të paktën një herë, e kishin rrahur keq duke ia thyer këmbën. Shyqeriu e kanë pushkatuar në **Malet e Berishës/Berishine planine** më 25 apo 26.07.1998, në kuadrin e grupit të të burgosurve. Mbetjet e tij mortore janë zhvarrosur nga varreza masive në **Malet e Berishës/Berishine planine** në muajin gusht të vitit 2001. Obduksioni i trupit të Shyqeriu ka konstatuar fraktura të shumta. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Shyqeriu në varrezat e Godancit të Poshtëm/Donje Godance, në muajin shkurt të vitit 2005. Për vrasjen e Shyqeriu dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

Burimet: deklarata S.Z, FDH-23589; IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 29.08.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Zavrсна%20rec%20Tuzilastva%20-%2029.08.2005..pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-66-);) AIS, *Zona...*, 35, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 72; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPF, *Regjistri i*